



Republika e Kosovës,
Kuvendi i Komunës së Junikut,
Numër: 02-/03/24,
Datë: 19.04.2024



Në bazë të nenit 8 paragrafi 8.3 të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut dhe në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal Nr.002/04 i datës 31.05.2018, kryesuesja e Komitetit për Komunitete të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: anëtarët e Komitetit për Komunitete,

Nga: Zejnepe Gaxherri – kryesuese e Komitetit për Komunitete të Komunës së Junikut,

Lënda: Mbledhja e tretë (3) e Komitetit për Komunitete,

Vendi: Salla e takimeve kati parë,

Data: 24.04.2024, ora 11⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit;
2. Siguria dhe kontrolli ndaj produkteve ushqimore.
3. Të ndryshme;



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RÉPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Referencë/Reference:	Nr. 02/07/24
PËR/ZA/TO:	z. Demokrat Ganiqaj – Drejtor për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrotjtje dhe Shpëtim - Komuna Junik
CC:	z. Ruzhdi Shehu-Kryetar i Komunës së Junikut
PËRMES	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal - Junik
NGA/OD/FROM:	znjsh. Zojnepe Gaxherri - kryesuese e Komitetit për Komunitete - Junik
DATE/A:	19.04.2024
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë

1. Informatë - Sigurija dhe kontrolli ndaj produkteve ushqimore.

Te nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme që kemi dhe duke qenë të vendosur që të kemi bashkëpunim edhe më tutje.

Të perkushtuar për zbatimin e Planit të Punës të Komitetit për Komunitete në Komunën e Junikut për muajin prill dt. 24.04.2024 me fillim ne ora 11.00 , ne sallën e mbledhjeve e kemi parapar të njoftohemi me Piken e lartëcekur në Kërkesën tonë.

Është një pikë e rendit të dites për të cilën kemi kerkuar Informata nga Drejtoria Juaj.

Prandaj kerkojmë nga ana e Drejtorisë së lartëcekur që të na sjellë Informatat per kerkesen e ngritur.

Shpresojmë që kërkesa jone do të gjejë mirëkuptim nga ana juaj!
Ju falënderojmë për bashkëpunim!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RÉPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Referencë/Reference:	Nr. 02/07/24
PËR/ZA/TO:	z. Demokrat Ganijaj – Drejtor për Sherbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim - Komuna Junik
CC.	z. Ruzhdi Shehu-Kryetar i Komunës së Junikut
PËRMES	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal - Junik
NGA/OD/FROM:	znjsh. Zejnepe Gaxherri - kryesuese e Komitetit për Komunitete - Junik
DATË/A:	19.04.2024
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë

1. Informatë - Siguria dhe kontrolli ndaj produkteve ushqimore.

Te nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme që kemi dhe duke qenë të vendosur që të kemi bashkëpunim edhe më tutje.

Të perkushtuar për zbatimin e Planit të Punës të Komitetit për Komunitete në Komunën e Junikut për muajin **prill dt. 24.04.2024** me fillim ne ora 11.00 , ne sallën e mbledhjeve e kemi parapar të njoftohemi me Piken e lartëcekur në Kërkesën tonë.

Është një pikë e rendit të dites për të cilën kemi kërkuar Informata nga Drejtoria Juaj.

Prandaj kerkojmë nga ana e Drejtorisë së lartëcekur që të na sjellë Informatat per kerkesen e ngritur.

Shpresojmë që kërkesa jone do të gjejë mirëkuptim nga ana juaj!
Ju falënderojmë për bashkëpunim!



KOMITETI PËR KOMUNITETE

Kuvendi Komunal-Junik
Nr. 02/02/24
Datë: 25.03.2024

PROCESVERBAL

i

Mbledhjes së Dytë të Rregullt të Komitetit për Komunitete, mbajtur me datën 25 Mars, 2024, në orën 11⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Zejnepe Gaxherri - kryesuese, përfaqësuese (LDK),
2. Eliza Pepshi - përfaqësuese (LVV),
3. Valdrin Isufaj - përfaqësues (Komuniteti i Biznesit), dhe
4. Zenel Maloku - përfaqësues (AAK).

Poashtu të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe drejtori nga Drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Junikut, z. Demokrat Ganiqaj, si dhe përfaqësuesi i OSBE-së nga Zyra Rajonale në Pejë, z. Edmond Dushi.

Mbledhjen e Dytë të Rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2024 e kryesoj znj. Zejnepe Gaxherri, e cila përshëndeti të pranishmit, si dhe prezantoi dhe kërkoi miratimin e Rendit të Ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Masat para dhe gjatë fatkeqësive natyrore; vërshimeve, zjarreve dhe fatkeqësive tjera, dhe
3. Të ndryshme.

Rendi i Ditës u shqyrtua, dhe me katër vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika e Parë e Rendit të Ditës

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesja, znj. Zejnepe Gaxherri kërkoj shqyrtimin dhe miratimin e këtij procesverbali, i cili shqyrtua, dhe me katër vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika Dytë e Rendit të Ditës

Masat para dhe gjatë fatkeqësive natyrore; vërshimeve, zjarreve dhe fatkeqësive tjera

Lidhur me këtë pikë fjalën e mori drejtori z. Demokrat Ganiqaj i cili tha, sa i përket vërshimeve fatmirësisht këtë vit nuk kemi pas vërshime sikurse dy vite më parë, që jemi ballafaquar me to. Kemi identifikuar pikat në bazë të vërshimeve paraprake, ndërsa vitin e kaluar kemi pasë vërshime në lagjen Çok të pompa e benzinës, ku ka pasë bllokim të kanalizimit në pronën e familjes Krasniqi.

Këtë vit kemi fillu me pastrimin e ujëmbledhësve përreth rrugëve, siç është rruga të pompa e benzinës “Molika”, në rrugën për lagjen Gaxherr, në rrugën për Nivokaz brenda territorit të Junikut. Tani jemi duke pastruar rrugën nga Dobroshi deri në Qendër, dhe pastaj mendojmë që të bëjmë pastrimin e shtratit të lumit Erenik.

Sa i përket zjarreve, kemi numër të kufizuar të stafit të zjarrfikësve, por kemi drejtuar kërkesa të AME, sepse ata e hapin konkursin, por nuk kemi akoma ndonjë përgjigje pozitive.

Njësia e zjarrfikësve në Junik ka marrë donacion nga KFOR-i siç janë; dana për intervenime në rast të aksidenteve, pra për prerje të makinave ose dyerve në rast të zjarreve nëpër shtëpi. Kemi pranuar edhe disa pompa të shpinës për zjarrfikës, si dhe kemi bërë servisimin e dy kamionëve të zjarrfikësve, të cilët kanë qenë në gjendje jo fortë të mirë teknike. Poashtu është bërë servisi i një pompe për nxjerrjen e ujit.

Hidrantët janë në gjendje të mirë dhe kohë pas kohe kontrollohen, në bashkëpunim të zjarrfikësve dhe firmës Hidro-drini, dhe kemi legalizuar dy nga këta hidrantë.

Kemi premtim nga KFOR-i Italian edhe për një donacion shtesë për disa pajisje fryrëse, disa pompa, dhe një dron, diku në vlerë prej rreth 10-12,000.00 Euro.

Zjarrfikësit janë të pajisur mirë me vegla të nevojshme në raste të intervenimeve.

Sot kemi dhe një kërkesë për dorëheqje të njërit zjarrfikës, z. Prenton Pepshi, i cili ka emigruar jashtë vendit. Tani sektori i Emergjencave ka mbetur vetëm me komandantin dhe një zjarrfikës. Ne tani do të bëjmë kërkesë për hapjen e menjëhershme të konkursit, pavarësisht se në raste të intervenimeve kemi bashkëpunim të mirë me Komunën e Deçanit dhe të Gjakovës, si komuna fqinje, si dhe me Komunën e Pejës, në ndonjë rast. Ky konkurs varet nga AME dhe jo nga ne.

Z. Valdrin Isufaj ceku largimin e urës së këmbësorëve mbi lumin Erenik te lagja Tofaj, ndërsa ceku edhe dëmtimet e shtratit të lumit Erenik, ndërsa pyeti nëse ura do të vendoset prapë, dhe nëse do të bëhet pastrimi dhe rregullimi i dëmtimit të shtratit të lumit?

Z. Demokrat Ganiqaj tha, vitin e kaluar gjatë vërshimeve e kemi larguar urën sepse i është prishur baza. Ne planifikojmë që ta vendosim këtë urën prapë, si dhe urën tjetër në Arasha, ndërsa mendojmë që të rehabilitojmë shtratin lumit, që është duke u dëmtuar kohë pas kohe. Kemi të kontraktuar një kompani projektuese dhe kemi filluar me matjet gjeodezike nga rampa e vjetër në Jasiq deri të Prita e Katundit, dhe tani kjo firmë është duke e bërë projektin. Kemi kërkuar edhe nga Instituti Meteorologjik që të na i japin statistikat e prurjeve të ujit nga bjeshka për dhjetë

vitet e fundit, në mënyrë që të dimë se sa duhet të jetë gjerësia e koritës së lumit, sepse sipas inxhinierëve këto vërshime dhe dëmtime kanë ndodhë për shkak se korita aktuale nuk i ka plotësuar tamam nevojat e prurjeve të ujit. Besojmë se këtë vit do ta kryejmë këtë projekt dhe do të aplikojmë nëpër ministri, ndërsa kemi premtime nga Banka Botërore për mbështetje të këtij projekti.

Z. Valdrin Isufaj ngriti edhe çështjen e bllokimit të kanalit të ujit të xhamia në Qendër, që siç tha ai po i bënë dëmtime në depon materialit ndërtimor të tij.

Z. Demokrat Ganijaj tha, nuk jemi në dijeni të këtij problemi, mirëpo do marrim masa për sanimin e tij.

Pika Tretë e Rendit të Ditës Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë të Rendit të Ditës nuk pati diskutime, ndërsa me kaq, kryesuesja znj. Zejnepe Gaxherri e shpalli të mbyllur mbledhjen e sotshme të Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtësi,

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete,

Gëzim Geci

Zejnepe Gaxherri



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E JUNIKUT MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/02/24;
Datë: 25.03.2024 .

Mbledhja e dytë (2024) e Komitetit për Komunitete - Junik
Data e mbajtjes së mbledhjes: 25.03.2024

Nr.	Emri dhe mbiemri	Përfaqësimi	Nënshkrimi
1	Zejnepe Gaxherri	Përfaqësuese e LDK-së	
2	Zenel Maloku	Përfaqësues i AAK-së	
3	Eliza Pepshi	Përfaqësuese e LVV-së	
4	Valdrin Isufaj	Përfaqësues - Komuniteti i Biznesit	
5	Safete Shehu	Përfaqësues -OJQ /Qershiza/	

Vërteton: Zejnepe Gaxherri _____
Kryesuese